



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 Tetor 2016
Nr. ref.:RK985/16

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KIo7/16

Parashtrues

Rifat Abdullahi

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së një aktvendimi për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Rifat Abdullahi, avokat nga Ferizaji, i cili supozon të jetë përfaqësues i A. A. (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

2. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar autorizim të vlefshëm para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), që do të dëshmonte se A. A. e ka autorizuar atë që të parashtojë kërkesë para Gjykatës.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesi i kërkesës konteston, në emër të A. A., një aktvendim për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesit që Gjykata, në emër të A. A., të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (5) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 janar 2016, parashtruesi i kërkesës, në emër të A. A., dorëzoi kërkesën e tanishme në Gjykatë. Ai e dorëzoi këtë kërkesë me një autorizim të vitit 2014, i cili veçse ishte shfrytëzuar para Gjykatës për një rast tjetër.
7. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 23 shkurt 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai, që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i shkresës të dorëzojë autorizimin që dëshmon se A. A. e ka autorizuar atë që ta përfaqësojë në Gjykatë.
9. Më 29 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi sërish në Gjykatë autorizimin e vitit 2014, i cili ishte përdorur për dorëzimin e një kërkesë të mëhershme të A. A. në Gjykatë.
10. Më 3 mars 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai duhet të dorëzojë një autorizim të ri në Gjykatë, meqë autorizimi i dorëzuar nuk është i vlefshëm, ngase i njëjti veçse është shfrytëzuar për një rast tjetër i cili është shqyrtuar nga Gjykata. Kjo e fundit i dha një afat prej 7 (shtatë) ditësh që të dorëzojë autorizimin e kërkuar.
11. Më 7 mars 2016, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj shkresës së Gjykatës, mirëpo, nuk dorëzoi autorizimin e kërkuar. Në letrën e tij drejtuar Gjykatës, ai

deklaroi: “Meqë bëhet fjalë për të njëjtën çështje nga viti 2014 [...] mendoj se nuk është i nevojshëm autorizimi i ri, megjithatë, unë pasi të bisedoj me të paraburgosurin A. A. [...] dhe me familjen e tij, do t’i përgjigjem shkresës suaj”.

12. Deri më sot, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar autorizimin e vlefshëm të kërkuar nga Gjykata, megjithëse, afati i përcaktuar nga kjo e fundit ka kaluar.
13. Më 14 korrik 2016, Kolegji shqyrtues, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht refuzimin e saj në bazë të rregullit 32 (5) të Rregullores së punës.

Përmbledhja e fakteve

14. Gjykata nuk ka autorizim që të përmend faktet lidhur me këtë rast, duke qenë se kërkesa është parashtruar nga një parashtrues i cili nuk ka dëshmuar të ketë autorizim për të parashtruar këtë kërkesë në emër të A. A.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Duke qenë se kërkesa është parashtruar nga një parashtrues i cili nuk ka sjellë autorizim të vlefshëm para Gjykatës, kjo e fundit nuk do të përmend pretendimet që supozohet se i përkasin A. A. në mungesë të një autorizimi formal për të bërë një gjë të tillë.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 7, i Kushtetutës, i cili parasheh:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Gjykata po ashtu i referohet nenit 21 [Përfaqësimi] të Ligjit, i cili parasheh:

“Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala”.

19. Më tej, Gjykata i referohet rregullit 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“[...] (2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...] (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor; [...].

(3) Nëse pala ka përfaqësues, përfaqësuesi dorëzon në Gjykatë, bashkë me kërkesën, autorizim të vlefshëm”.

20. Gjykata vëren se përkundër kërkesave të saj që të dorëzohet një autorizim i ri i vlefshëm në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar dokumentin e kërkuar. Ai ka insistuar që *“autorizimi i dt. 20.08.2014 është i vlefshëm”* meqë *“bëhet fjalë për të njëjtën çështje nga viti 2014”*.
21. Në dritë të këtyre fakteve, Gjykata i referohet edhe rregullit 32 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“[...] (5) Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose ta qartësojë kërkesën [...]”.
22. Në zbatim të këtij rregulli, Gjykata konstaton se kërkesa në fjalë është jo e plotë për arsye se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar autorizimin që dëshmon se A. A. e ka autorizuar atë, që të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në emër të tij. Përkundër kërkesave të Gjykatës, parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar kërkesën e parashtruar me dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga Gjykata.
23. Si përfundim, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 21 të Ligjit, si dhe rregullat 29 dhe 32 (5) të Rregullores së punës, më 14 korrik 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Selvete Gërxhahu-Krasniqi

Arta Rama-Hajrizi

